

- *Të sigurojmë integritet të drejtimit strategjik.*
- Të harmonizojmë punën me bizneset dhe sektorë të tjerë të ekonomisë e me shoqërinë civile.*
- *Të hartojmë një plan veprimi afat mesëm dhe ta rishikojmë atë periodikisht*

Strategjia e turizmit dhe Agroturizmit

REPUBLIKA E SHQIPËRISË KESHILLI QARKUT LEZHE

Arbana Dibra

Gjovalin Gjeloshi
Preng Gjomarkaj

Perktheu ne gjuhen angleze:

Linda Maçi

Korrektor:

Hartuan dokumentin :

Dylbere Meshi
Viktor Gjokolaj

Botim i Këshillit të Qarkut Lezhë nën kujdesin e Kryetarit të Qarkut Lezhë
Z. Bardh Rica

Strategjia e turizmit dhe Agroturizmit në Qarkun e Lezhës

3.1. Lezha
3.2 Kurbini
3.3 Mirdita

2.1.1. Qarku i Lezhës
2.1.2. Klima
2.1.3. Sporti i skive dhe alpinizmi

1 . Hyrje 2. Vështrim gjeo- historik i qarkut Lezhë

Përmbajtja

Strategjia e turizmit dhe Agroturizmit në Qarkun e Lezhës

3. Vështrim historiko- kulturor

4. Turizmi

4.1. Tradita turistike

4.2. Analizë e gjendjes aktuale

5. Te dhëna për turizmin

5.1. Vizioni

5.2. Objektivat

5.3 Objektivi i parë –Turizëm i qëndrueshëm gjatë gjithë vitit

i – Partneriteti shtet –privat

ii – Cilësia e shërbimit

iii- Mbrojtja e mjedisit

iv-Qetësia e siguria

v- Infrastrukturë funksionale

6. Objektivi i dytë - Të zhvillojmë turizëm të harmonizuar, bregde- tar, malor , historik e etno – kulturor

7. Objektivi i tretë – Të krijojmë imazh pozitiv

9.2.2. Objektivi i dytë –Krijimi i fermave të mëdha e të qëndrueshme sipas eksperiencave përendimore

të dalë në tregun turistik me prodhime biologjikisht të pastra

Strategjia e turizmit dhe Agroturizmit në Qarkun e Lezhës

8. Plani i veprimit

9. Objektivi i katërt – Agroturizmi

9.1 Analizë e gjendjes aktuale

9.2. Objektivat

9.2.1 Objektivi i parë- Rritja e prodhimit bujqësor e blegtoral për

9.2.3. Ruajtja e traditës bujqësore dhe blegtorale nga fermerët

9.3. Plani i veprimit

tregtisë, Zyra e statistikës Lezhë , Drejtoria Rajonale e Monumenteve të Kulturës, Muzeu Historik Lezhë, Muzeu Mirditë, Qendrat kulturore Kurbin, Lezhë, Mirditë, Fondi statistikor i Institucionit, etj..

Strategjia e turizmit dhe Agroturizmit në Qarkun e Lezhës

HYRJA 1.

Të zhvillosh turizëm nuk mjafton vetëm të kesh, por të dish ta administrosh!

Strategjia e Turizmit dhe Agroturizmit në Qarkun e Lezhës u hartua nga ekspertë të Drejtorisë së Programim Zhvillimit të Këshillit të Qarkut Lezhë në bashkëpunim me aktorë e faktorë të tjerë rajonalë: njësitë vendore, drejtoritë rajonale, grupet e interesit, OJF, qytetarët etj.

Hartimi i këtij dokumenti u mbështet në :

Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013, Strategjinë Ndërsektoriale të Zhvillimit Rajonal 2007-2013, Strategjinë Sektoriale Kombëtare të Turizmit 2007-2013 , Ligjin Nr. 9734 “Për turizmin”, datë 14.05.2007 .

Të dhënat u morën nga :

Njësitë Vendore, Drejtoria e Tatim Taksave, biznesi, Dhoma e

III-Thithja e investitorëve të huaj e vendas për përmirësimin e infrastrukturës , rritjen e punësimit, rritjen ekonomike, përmirësimin e jetesës dhe uljen e varfërisë.

IV- Nxitja e bashkëpunimit mes sektorit privat e publik për zhvillimin e turizmit .

vlerësuar në mënyrë analitike resurset njerëzore, natyrore, historiko- kulturore e për t'i kthyer ato në produkte turistike për tregun rajonal .

II- Ngritja e kapaciteteve njerëzore në funksion të ngritjes së kulturës së shërbimit në nivelin e standardeve ndërkombëtare .

Qëllimi i hartimit të këtij dokumenti :

I –Identifikimi i adresimit turistik në qarkun e Lezhës, duke

V. Ta bëjmë Rajonin e Lezhës një potencial konkurrues në tregun turistik kombëtar

Sipas ndarjes klimatike të Shqipërisë, Qarku i Lezhës bën pjesë në zonat mesdhetare fushore, paramalore dhe malore, me 250 - 300 ditë me diell në vit, me rreth tre muaj në vit të përshtatshme për turizëm balnear (qershor, korrik, gusht). Në bregdetin me gjatësi rreth 38 km, përfshihen plazhet e Shëngjinit, Ranës së Hedhun, Tales, Patokut shoqëruar me në brendësi me komplekset lagunore Kune-Vain e Patok.

2

2.

1.588.4km²,
me reliev fushor, kodrinor dhe malor, ku ultësira zë 35% të saj dhe pjesën
tjetër prej 65% e zë relievi kodrinor - malor.

me rritje populsi me 0.64% në vit.

Popullsia urbane 40% dhe ajo rurale 60 %.

Popullsia 216 000 banorë, me dendësi mesatare 133 banorë/km

VËSHTRIM GJEO-HISTORIK I QARKUT LEZHË

2.1.2.Klima

2.1. Disa veçori fiziko-gjeografike.

Strategjia e turizmit dhe Agroturizmit në Qarkun e Lezhës

2.1.1.Qarku i Lezhës

Shtrihet në veriperendim të Shqipërisë, me një sipërfaqe 1.588.4km

Qarku i Lezhës, përbëhet nga rrethet Lezhë, Kurbin, Mirditë. Harta administrative e tij ka 16 Komuna dhe 5 Bashki, 9 qytete e 170 fshatra.

2.

Për turistët e aventurës, një rrjet i dendur me shpella karstike, përbën një destinacion turistik interesant .

Ka një relief të favorshëm, por ka pak traditë , sidomos në ski .

2.1.3 Sporti i skive dhe alpinizmi

Bjeshkët e larta të Mirditës, Kurbinit e Malësisë së Lezhës, janë të veshura me pyje të shumëllojta ,prej nga rrjedhin lumenj e burime ujore të pastra e të ftohta . Me vlera të veçanta kurative është Kroi i Bardhë në Kunorën e Selitës, etj.

E gjithë zona kodrinore e malore e Qarkut, është e pastër nga ndotjet kimike dhe industriale.

Klima po pëson ndryshime të cilat pritet të ndikojnë në ekosistemet natyrore dhe sektorët social ekonomike. Deri në fund të shekullit në vazhdim, si rrjedhojë e këtyre ndryshimeve te klimës, periudha e përshtatshme për turizmin balnear pritet të dyfishohet dhe të rritet preferenca për turizëm malor, ndërsa si rrjedhojë e rritjes së nivelit të detit plazhet pritet të zhvendosen më në brendësi të territorit. Kjo kërkon që zhvillimi i infrastrukturës turistike të orientohet në pjesët e ngritura të bregdetit, ndërsa objektet turistike të ndërtohen me materiale dhe teknologji që do t'a përshtatin ndaj ndryshime te klimës.

Strategjia e turizmit dhe Agroturizmit në Qarkun e Lezhës

Qyteti antik i Lezhës, themelet e të cilit u hodhën në vitin 385 p.e.s. është një vlerë e madhe e trashëgimisë kulturore të vendit tonë.

Kuvendi i Lezhës që u mblodh 2 Mars 1944 i quajtur Kuvendi i Besëlidhjes. Kuvendi i Arbnit u mbajt më 1703, në Merqi të Lezhës.

VËSHTRIM HISTORIKO-KULTUROR 3.

Lezha është shpallur Park Arkeologjik.

Strategjia e turizmit dhe Agroturizmit në Qarkun e Lezhës

Trevat e Lezhës, Kurbinit dhe Mirditës që përbëjnë Qarkun e Lezhës, janë trevat që kanë arkivuar në historinë tonë ngjarje me rëndësi të madhe kombëtare.

3.1. Lezha

3.2. Kurbini

Më 1632 ,në Kurbin hapet shkolla e parë shqipe.

Rrethi i Kurbinut është një zonë që ka lënë gjurmë në historinë kombëtare. Dëshmi të zhvillimeve historike janë:

Kalaja e Sebasties, Beteja e Albulenës, ku shënohet një nga fitoret më të bujshme të Skënderbeut.

Fshati Skuraj është fshat historik që lidhet me epopenë e qëndresës historike anti-osmane.

Mirdita është dhe i shtetit të parë të Arbnit.

Në Ndërfanë është zbuluar stema e Arbnit që ruhet në Muzeun Historik Kombëtar.

Banorët e hershëm të Mirditës ishin pirustët, të cilët njihen edhe si nxjerrës e përpunues të bakrit

Strategjia e turizmit dhe Agroturizmit në Qarkun e Lezhës

3.3. Mirdita

Unioni i 12 bajrakëve të Mirditës, është shembull i vetëqeverisjes tradicionale. Vlerë e veçantë e kësaj krahine ishte qëndresa anti osmane.

I gjithë rajoni i Lezhës, ka një atlas të pasur me vepra të hershme të kultit, ku dominojnë kishat e katedralet e vjetra katolike si :

Ipushkiva e Sapës (Zadrimë),

Kisha e ShnaNdout në Laç, Abacia e Oroshit ,

Kuvendi Franceskan i Rubikut,

Kuvendi Franceskan i Lezhës, Xhamia e Lezhës.

Kuvendi Franceskan i Troshanit

Qendra Ipushkvnore Kallmet

Bashkëjetesa fetare ,ashtu si kudo në Shqipëri, është një vlerë qytetare që ruhet dhe forcohet vazhdimisht.

Prej shekujsh thuhet : .

“Shtëpia është e Zotit dhe e mikut”

TURIZMI 4.

Nuk mund të litet për ndonjë traditë të zhvillimit turistik në vendin tonë, për shkak të izolimit me botën dhe varfërisë brenda vendit.

Pas luftës së dytë botërore në qendrat e rretheve, funksiononin të ashtuquajturit “Hotele Turizmi”, ku frekuentoheshin kryesisht nga vendasit.

Në Rajonin tonë, kanë funksionuar tre hotele të tilla: Hoteli i Gjuetisë i ngritur në vitet 40-t dhe i ideuar nga Konti Çiano , Ishull-Lezhë, Hoteli “Lisus” në qytetin e Lezhës dhe

hoteli i qytetit të Rrëshenit. Në qytetin e Laçit, nuk ka pasur të tillë, pasi administrohej nga rrethi i Krujës. Këto njiheshin si hotelet më cilësorët, me restorantet e tyre ku tregtoheshin prodhime vendase.

Kanë funksionuar në mënyrën e vet ekskursionet kolektive të ndërmarrjeve, shkollave dhe institucioneve të ndryshme në vise me bukuri natyrore të veçantë. Vizitat në “veprat e pesëvjeçarëve”, në muzetë e luftës dhe në muzetë etnografikë, ishin trajtë e turizmit të asaj kohe.

Strategjia e turizmit dhe Agroturizmit në Qarkun e Lezhës

4.1 . Tradita turistike

Të huajt që kanë vizituar Rajonin tonë si E.Durham, F.Nopça T.Ipen, etj. kanë shkruar edhe për mikpritjen e bujarinë e njerëzve të këtyre anëve.

Në fillim të viteve '40-t është ndërtuar një hotel me një arkitekturë Italiane të veçantë që u quajt **“Hoteli i gjetisë”**, me ambiente të jashtme të bukura e shlodhëse në një mjedis me drurë, shkurre, lulishte , një liqen i vogël natyral , etj. Për njerëzit e thjeshtë ishte një mollë e ndaluar sepse shërbente kryesisht për pritjen e delegacioneve të huaja.

frekuentohej si plazh ditor dhe rezident për qytetarët e Shëngjinit, Lezhës dhe zonave për rreth.

Në qytetin Shëngjin para viteve '90-të, kanë funksionuar disa kabina të vogla për pushues, kampi i punëtorëve në 6 godina 2 katshe, me 80 dhoma, me 230 shtretër, kampi i pionierëve në 24 dhoma të mëdha me rreth 450 shtretër, me dy restorante dhe me ambiente si lulishte, bibliotekë, sallë argëtimi, shëndetësie etj. Në të gjithë sipërfaqen prej rreth 4 ha. gjendeshin krahas kampit hotel “Flutura” dhe dy godina tre katshe. Të tilla kabina ka pasur edhe në plazhin e Patokut. Ndërsa pjesa më e bukur, Laguna e Kune-Vainit, ishte zonë e ndaluar për qytetarët sepse pushonin e bënin gjueti vetëm pushtetarë të asaj kohe. Një pjesë e saj ishte zonë ushtarake.

Plazhi i Shëngjinit

Është ndër plazhet më të vjetra të vendit tonë, i cili prej vitesh

Një zhvillim të vullshëm mori turizmi në rajonin e Lezhës pas lëvizjeve demokratike në Shqipëri. Instalimi i tregut liberal, hapi mundësi të mëdha të zhvillimit të turizmit në vendin tonë. Edhe në Qarkun e Lezhës u ngrit një rrjet i gjerë me objekte turistike në bregdet, si dhe në zonat malore. Një varg hotelesh, motelesh, restorantesh moderne e tradicionale shtrihen përgjatë bregdetit, duke e bërë atë më tërheqës në shtimin e numrit të turistëve vendas e të huaj.

Ishull -Lezhë

Strategjia e turizmit dhe Agroturizmit në Qarkun e Lezhës

Hoteli i Gjuetisë në Ishull – Lezhë është pionier i turizmit modern në rajonin e Lezhës.

Qarku Lezhë, ka një zhvillim të mirë të turizmit bregdetar, veçanërisht në plazhin e Shëngjinit, me infrastrukturë të ngritur, me kapacitete akomoduese në rritje. Sektori privat ka investuar me shërbim të mirë e me shumë hotele luksoze.

Bregdeti, nga Rana e Hedhun e në vazhdim, ka rërë cilësore të pastër e të pasur me jod, veçanërisht në pjesët e pa shfrytëzuara si në **Tale, Adriatik** etj, të cilat po frekuentohen, nga viti në vit, gjithnjë e më shumë.

Në breg të detit të Shëngjinit pas, rërës vjen një brez pishash deri në fund të Kunes, ndërsa në pjesën ku lidhet me Vainin në bregdet vazhdon me një pyll me pisha e drurë të tjerë shumëvjeçarë, por është i izoluar në të dy anët, për mungesë të dy urave dhe infrastrukturës tjetër të nevojshme. Veçanërisht ne 20 vitet e fundit, në këtë zonë po bëhen me të dukshme presionet në rritje nga efektet e ndryshimeve klimatike, si erozioni i lartë bregdetar (çdo vit deti përparon në drejtim të tokës mesatarisht deri në 3 m), përmblytjet e fuqishme të zonës bregdetare si rezultat i ngjarjeve ekstreme klimatike, të stuhive detare e baticës së lartë.

Plazhet tona, frekuentohen nga maji deri në shtator, me turistë ditorë e rezidentë vendas e të huaj. Funksionon një rrjet shërbimi tregtar si dhe njësi të vogla, që u shërbejnë pushuesve me çadra e shezlonge.

Bëhet çdo natë pastrimi i rërës së bregut të detit nga pronarët e hoteleve dhe pjesa tjetër nga punonjësit e komunës. Lëvizja e qytetarëve kryhet zakonisht me autobusë e furgone dhe mjete të tjera private.

Këto plazhe, frekuentohen çdo vit nga turistë vendas, emigrantë, për diellin, detin, rërën, ajrin e pastër, për qetësinë dhe për bukurinë e rralla të lagunave Kune- Vainit, Patokut të pasura me shumëllojshmëri të florës e faunës.

Në Komunën Shëngjin, funksionon **turizmi familjar**, me kushte të mira shërbimi, e me çmime konkurruese, që shtojnë numrin e pushuesve vit pas viti. Shërbejnë afërsisht 550 shtëpi private të tilla që jepen me qera gjatë sezonit të plazhit.

Nga të dhënat e komunës Shëngjin në sezonin e plazhit vijnë mbi 5000 pushues në ditë rezidentë e kalimtarë krahas shumë vizitorëve që vijnë gjatë gjithë vitit për monumentet historike etno – kulturore në teritorin e Qarkut.

Analiza e gjendjes aktuale të resurseve që ka Qarku Lezhë, tregon se turizmi do të jetë një ndër burimet kryesore të zhvillimit social –ekonomik që **do të konsiderohet si prioritet** në planet afatmesme e afatgjatë, që do të çojë në rritjen ekonomike dhe zhvillim të Rajonit, duke iu afruar fqinjëve veriorë në vazhdim si Malit të Zi, Kroacisë, Sllovenisë etj..

Strategjia e turizmit dhe Agroturizmit në Qarkun e Lezhës

4.2 . Analizë e gjendjes aktuale

Në vitet 1990 4 7 214 680 2007-08 13 24 979

3054

Numri i turistëve ditorë e rezidentë për vitin 2009, ka patur një rritje prej rreth 20% krahasuar me vitin 2008. (sipas të dhënave të komunës Shëngjin.)

Në gjithë zonën bregdetare të Qarkut shërbejnë lokale të nivelit të lartë, me gatim tradicional dhe atë bashkëkohor, të furnizuar nga një treg i pasur me fruta e perime të pastra biologjikisht, si dhe verën e famshme të Kallmetit, verën “Arbëri” të vreshtës së Bukmirës, rakinë prodhuar nga fermerët e zonës etj...

Sip.shfrytzuar Nr. Hoteleve
plazhi ha. Në k.Shëngjin

Nr.DhomaveNr.shtretërve

Nr. hoteleve
Në k.Shëngjin Nr. dhomave Nr. shtretërve

Strategjia e turizmit dhe Agroturizmit në Qarkun e Lezhës

Sip.shfryt- zuar plazhi ha.

1500 2000 2500 3000 3500

0 500 1000

20 25

10 15

0 5

Në veri të Shëngjinit, ndodhet Rana e Hedhun me një peisazh të mrekullueshëm, një vis piktoresk, ku rrinë bashkë deti, rana, mali i veshur me pisha e drurë, por e pa shfrytëzuar deri me tani për arsye të mungesës së infrastrukturës. Për këtë pjesë të Shëngjinit, kanë shfaqur interes shumë pronarë biznesmenë të nivelit të lartë botëror(zviceranë, italianë ,amerikanë etj.).

Në rrethin Lezhë ushtrojnë aktivitetin 28 hotele,7 motele, me 3945 shtretër. Funkcionojnë 118 lokalë shërbimi nga ku 57 janë restorante të cilësisë së lartë.

Ndërtimet e reja, që po ngrihen në afërsi të bregdetit të Shëngjinit, shtojnë mundësinë e pritjes të një numri më të madh turistesh vendas e të huaj.

cilat kërkojnë vëmendje për përmirësimin e infrastrukturës.

Plazhet e Tales, Adriatikut e Ranës së Hedhun

Janë në fillimet e shfrytëzimit të tyre dhe me ecuri mjaft premtuese, të

derdhje të lumit Ishëm, në kufi me Gjirin e Lalzit .

Patoku

Me vijë bregdetare rreth 10 km, fillon në derdhje të Matit e deri në

me thellësi nga 1,5 - 5 metra, me natyrë të virgjër, me florë dhe faunë të pasur, ka disa lokale, të cilat gatuajnë shpendët dhe peshkun e freskët të lagunës.

Në sezonin e gjuetisë, kjo zone, gjallërohet nga shumë amatorë të sportit të gjuetisë, të huaj e vendas.

Dallohen disa lokale, njëri prej të cilëve tashmë është çertifikuar nga Instituti Italian i Çertifikimit **për cilësinë e kuzhinës**, në qershor 2008.

Laguna e Kune-Vainit,

Me një sipërfaqe 180 ha tokë lagunore dhe 1050 ha sipërfaqe ujore,

Është shumë e dëmtuar rruga Shëngjin – Kune, e cila duhet të trajtohet si prioritare.

Fuqizimi i Portit të Shëngjinit dhe vendosja e linjës për transport udhëtarësh, ka shtuar numrin e turistëve që udhëtojnë me traget.

Zgjerimi i Portit sipas masterplanit do të krijojë mundësinë e ankorimit e varkave lundruese e jahteve në brigjet e detit të Rana e Hedhun, po ashtu edhe rritjen e kapaciteteve të flotës së peshkimit.

Strategjia e turizmit dhe Agroturizmit në Qarkun e Lezhës

Brenda këtij territori gjendet zona Gotull me sipërfaqe 600 ha, me florë dhe faunë shumë të pasur, me pyje e shkurre pronë shtetërore .

Bregdeti i kësaj zone, është 6 km deri në Shllina, me rërë të pa shfrytëzuar , me të njëjtët tregues si më sipër, por nuk ka infrastrukturën

e nevojshme. Laguna e Patokut, në pjesën e dytë të saj, ka bregdet që është në proces të rikonfigurimit.

Anës së rrugës superstradë-Patok, ka disa lokale të reja që tregtojnë prodhime të freskëta të detit e shpendët e zonës, me çmime të leverdishme, por një pjesë e rrugës Vodafon-Adriatik- bregdet, afërsisht 2 km, është në gjendje jo të mirë. Për gjithë këtë zonë është emergjent një plan studimi mjedisor, për të zgjidhur problemin e madh të ndotjeve që sjell Lumi Ishëm, Lumi Tirana dhe studim për rehabilitimin e ujërave të zeza të Fushë Krujës e Tiranës.

Ndërtimi i rrugës turistike gjatë vijës bregdetare Superstradë-Patok- Tale-Shëngjin-Velipojë-Ulqin, projekt i EPTISA, që është ratifikuar nga qeveria do të lehtësojë lëvizjen

dhe do të krijojë kushte për shtimin e vizitorëve vendas e të huaj, do të nxjerrë në pah bukuritë natyrore të bregdetit të vendit tonë si vazhdim i bukurive natyrore të Malit të Zi, Kroacisë, Sllovenisë etj.

Ka filluar punimet për ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza Shëngjinit dhe gjithashtu po ndërtohet impianti i përpunimit

Strategjia e turizmit dhe Agroturizmit në Qarkun e Lezhës

(ligatina).

Vukaj 16 50 5 5 6

shtreter r

**Me dy
krevate Familjare 1 dite 15 dite**

Strategjia e turizmit dhe Agroturizmit në Qarkun e Lezhës

Komuna Shëngjin

**Hotele Dhoma Çmim mesatar
ne leke/Euro**

Emertimi Nr.

5. TË DHËNA PËR TURIZMIN

Boga 20 60 - 10 10 20 € San Gjo 14 26 2 2 10 20 €

Palma 5 16 2 - 3 20-25 € Joni 18 72 - - 18 25 € President 27 48 2 2 - 3000

Besa 18 48 12 - 6 3000

20- 35000l

**Brilant 18 56 - 8 10 25 € Royal park 27 84 9 3 15 30/40€ ErmirPalac 129 456 12 18
99 12-17l**

Tropikal ? ? Dora 114 730 Samanda 8 32 - - 8 10 € Antag 36 24 - - 6 -

Riviera 15 56 - 2 13 15 € Gjuetari 16 64 - - 16 - 400 €

Frojdi 27 34 - - - - Ardoni 18 72 - - 18 20 € -

Kumanova 15 30 - - - -

Gjithsej 423 1958 44 50 258

Trashëgimi të pasur arkeologjike, etnokulturore e historike

Burime njerëzore të mjaftueshme

Shumëllojshmëri resursesh natyrore.

Prania e Portit të Shëngjinit

Pozicion gjeografik të favorshëm, vijë bregdetare 38 km

Strategjia e turizmit dhe Agroturizmit në Qarkun e Lezhës

Mungon kujdesi për mjedisin

Marrja parasysh e efekteve të ndryshimeve klimatike në të gjitha projektet e investimet

Zbatimi i masave për adaptim ndaj ndryshimeve të klimës, sidomos për mbrojtjen e mjedisit bregdetar

-Të përmirësojmë kushtet e përgjithshme të jetesës në Rajon.

- Të nxisim prodhimin vendas .

-Të ruajmë mjedisin

-Të zhvillojmë një infrastrukturë turistike të përshtatshme për të përballuar rritjen e temperaturave me rreth 5°C dhe rritjen e nivelit të detit me rreth 60 cm, deri në vitin 2100.

-Të mbrojmë e të pasurojmë trashëgiminë kulturore, historike e artizanale.

-Të forcojmë traditën e mikpritjes edhe nëpërmjet përmirësimit të shërbimit.

-Të rrisim në maksimum potencialet e turizmit për të qënë turizëm i qëndrueshëm , afatgjatë dhe i harmonizuar: turizëm bregdetar , malorë , etnokulturor e historik

- Të rrisim kapacitetet turistike ne zonat e freskëta malore ne përshtatje me ndryshimet klimatike.

Zbatimi i ligjit për mbrojtjen e Parkun arkeologjik

Investime të mjaftueshme në turizëm

Miratimi i plotë i studimit të vijës bregdetare

Mungon tradita e turizmit familjarë

Promovim dhe marketing i mirë

Synojmë :

- Të gjenerojmë të ardhura e vende të reja pune.

Ç'farë na mungon?

Studimin Urbanistik të zhvillimit të turizmit dhe mbrojtjes së bregut në zonën turistike të Gjirit të Drinit me një sipërfaqe rreth 1100 ha

Çfarë kemi ?

Strategjia e turizmit dhe Agroturizmit në Qarkun e Lezhës

Qarku i Lezhës, pjesë integrale e destinacionit të rëndësishëm turistik, Shqipëria e veriut, me një turizëm të qëndrueshëm, të zhvilluar në mënyrë të balancuar: detar, rural , kulturor e të integruar në ekonominë rajonale.

5.2. Objektivat

I -Të kemi një turizëm të qëndrueshëm përgjatë gjithë vitit.

II -Të zhvillojmë turizëm të harmonizuar bregdetar e malor, historik e etno-kulturor.

III -Të krijojmë një imazh pozitiv në rritje për zonën tonë dhe atë kombëtare.

IV. -Të zhvillojmë agroturizmin

5.3 Objektivi I :

Turizëm i qëndrueshëm përgjatë gjithë vitit

Me turizëm të qëndrueshëm kuptojmë organizimin e veprimtarive turistike rajonale, mbështetur në politikat kombëtare të zhvillimit, Organizatës Botërore të Turizmit, për qëndrueshmëri ekologjike, ekonomike ,social-kulturore dhe të sigurisë për t'ju përgjigjur

kërkesave të brendshme e të jashtme në rritje.

Qeveria shqiptare i ka dhënë prioritet zhvillimit të turizmit në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim e Integrim 2007-2013, Strategjinë Kombëtare të Turizmit 2007-2013, të cilat janë shoqëruar me plane veprimi, ku përfshihet dhe Qarku Lezhë.

Për të realizuar një turizëm të qëndrueshëm e gjithëvjetor do të mbështetemi në **disa tregues kryesor :**

i. Partneritet shtet – privat

Është miratuar ligji i ri i turizmit, ku Këshilli i Qarkut Lezhë ka qenë pjesë aktive në diskutimin e tij. Tashmë në nivel kombëtar ka një ligj për partneritetin publik - privat, gjithashtu në nivel rajonal është ngritur dhe funksionon Këshilli i Partneritetit, ku 1/3 vjen nga sektori privat.

5.1. Vizioni

sipërfaqe

të gjelbërta dhe rreth 6200 drurë dekorative, të cilët janë të pa mjaftueshëm.

2

Mbrojtja dhe pasurimi i mjedisit, është ndër treguesit kryesor që ndikon drejtpërsëdrejti në ruajtjen e bukurive të peizazhit natyror në shëndetin e njeriut dhe afeksionet që krijojnë për këdo. Masat e mara në këto dy vitet e fundit nga qeveria në mbjelljen e fidanëve pyjorë dhe bilanci pozitiv i prerje-mbjelljeve, janë hapat e para të ndryshimit në këtë sektor.

Në territorin urban të Qarkut kemi rreth 190 000 m

Në të gjitha diskutimet që ndërmerren në hartimin e politikave zhvillimore afat mesme dhe afat gjata, Qarku ka bërë kujdes që të marrë në konsideratë sugjerimet që vijnë nga sektori privat për t'i zbatuar ato në planet e zhvillimit. Këshilli i Qarkut në bashkëpunim me Dhomën e tregtisë dhe me Sektorin privat në përgjithësi, ka bashkëpunuar në ngritjen e strukturave që rregullojnë marrëdhëniet qeverisje vendore – biznes, të tilla si shkëmbimi i ndërsjellët i informacioneve lidhur me mundësitë e financimeve në infrastrukturën turistike si në bregdet ashtu edhe në zonat malore. Politikat e reja për investime duhet të shikohen në drejtim të krijimit lehtësirave për nxitjen e investimeve nga emigrantët shqiptarë.

41 Strategjia e turizmit dhe Agroturizmit në Qarkun e Lezhës

ii. cilësia e shërbimit .

Bizneset krahas traditës, në zonat turistike, veçanërisht po vlerësojnë shumë cilësinë e shërbimit, si higjienën e nivelit të lartë, gatimin tradicional e bashkëkohor, përmirësimin

e vazhdueshëm të etikës dhe njohjen e gjuhëve të huaja , etj.

Nga kjo konkurrencë janë vënë re shumë përmirësime, të cilat duhet të vazhdojnë. Me gjithë këto arritje është e nevojshme të organizohen kurse dhe eksperiencia të ndryshme kualifikimi për përmirësimin e cilësisë së shërbimit.

Zgjerimi i shkollave profesionale me drejtim hoteleri- turizëm, do të rrisë shumë cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

iii. Mbrojtja e mjedisit

Kuqe	Kurbin	5007			
1	IV	1940	Kune	Lezhë	800
2	IV	1940	Vain	Lezhë	1500
			Bjeshka e Oroshtit	Mirdite	4700
Total	IV	1940-2010	5	Qarku	12887
4	IV	1977	Berzane	Lezhë	880
5	IV	1996			

Nr. Kategoria Miratimi Zona e mbrojtur Rrethi Sip. ha.

Dëmtimet e pyjeve nga zjarri mbeten shqetësim i madh për të gjithë, prandaj kërkohet të merren masa parandaluese emergjente nga njësitë vendore në bashkëpunim me Drejtoritë përkatëse .

Për dëmet nga erozioni puna është në fillimet e saj, në ndërtimin e brezave mbrojtës dhe inventarizimit të gjithë zonës. Problematik është ndalimi i shfrytëzimit të paligjshëm i shtretërve të lumenjve Mat e Drin, Drojë etj.. dhe mbrojtjen e faunës nga gjuetia e paligjshme.

Në territorin tonë sipas ligjit njihen shumë zona të mbrojtura, për të cilat nuk bëhet kujdesi i duhur .

Qarku ka 92 510 ha me pyje e ndarë sipas rretheve:

Lezha 17 990 ha ,
Mirdita 64 320 ha,
Kurbini 10 200 ha.

Strategjia e turizmit dhe Agroturizmit në Qarkun e Lezhës

Rrjeti i zonave të mbrojtura në Qarkun Lezhë.

3 IV 1962-2010 Patok- Fush-

iv. Qetësia dhe siguria

Rritja e standarteve ekonomike , përmirësimi i vazhdueshëm i legjislacionit dhe vullneti i të gjitha palëve për të zbatuar , ndërgjegjësimi i komunitetit dhe bashkëpunimi me organet e policisë , kanë bërë që siguria publike të ketë përmirësime të dukshme. Ky përmirësim ka ndikuar në shtimin e numrit të vizitorëve dhe zgjerimin e rrjetit të shërbimeve. Anëtarësimi i Shqipërisë në NATO, ka bërë që Shqipëria tashmë të shikohet si një vend i sigurtë për të lëvizur e investuar. Investitorët e huaj këto dy vitet e fundit në Lezhë po investojnë me vlera të konsiderueshme që tregon se kanë gjetur në Lezhë një klimë të favorshme dhe siguri për kapitalet e tyre.

-Stimulimi i turizmit familjar bregdetar dhe në zonat rurale

-Ndërgjegjësimi i qytetarëve për ruajtjen e mjedisit.

-Respektimi i ligjit për zonat e mbrojtura.

-Përmirësimi i higjienës në ambientet e plazhit.

- Forcimi i partneritetit publik – privat

- Marrja në konsideratë e masave përshtatëse ndaj ndryshimeve klimatike në të gjithë veprimtaritë në mjedis e në aktivitetin social ekonomik

-Veshja me pyje të reja në të gjithë zonën kodrinore dhe malore.

rritur konkurrencën në tregun ndërajonal. -Shtimi i ambienteve të gjelbërta.

-Të zgjedhësh modelin e shërbimeve turistike dhe ta përsosësh për të -

-Ndërtimi i shetitores së Shëngjinit (sipas planit urbanistik)

-Ndërtimi i parkingjeve

-Ndërtim i impjanit të përpunimit të ujërave të zeza

-Ndërtimi i rrugëve lidhëse të bregdetit me akset kryesore

Rehabilitimi i sistemit të ujërave të zeza në zonën bregdetare

-Miratimi i Planit urbanistik të bregdetit duke mbajtur parasysh ndryshimet klimatike.

-

Duhet të bëjmë:

Shumë segmente rrugore që lidhin me bregdetin e qarkut Lezhë janë të rikonstruara . Mbetet të përmirësohen rrugët e brendshme të vijës bregdetare sidomos ajo Shëngjin – Kune – Vain .

Ndërtimi i rrugës Durrës - Morinë është kthyer në një korridor të rëndësishëm të shkëmbimit për fuqizimin e industrisë turistike .

Për zhvillimin e turizmit malor, atë të skive , speleologjisë, ekoturizmit duhet të kryhet një vlerësim i vendeve turistike të zonës malore dhe rurale në përgjithësi, në këtë kontekst duhet përmirësuar dhe rrjeti rrugor komunal . Është nevojshme dhe e domosdoshme të ketë hartë turistike rajonale dhe sistem sinjalistike të vendosur në të gjithë territorin. Për të siguruar një turizëm gjithëvjeter e të qëndrueshëm duhet përmirësuar furnizimi me ujë të pijshëm 24 orë dhe energji elektrike në të gjitha zonat turistike. Decentralizimi i sektorit të ujësjellës- kanalizime do të ketë impakt pozitiv në shërbimet turistike.

Strategjia e turizmit dhe Agroturizmit në Qarkun e Lezhës

v. Infrastruktua funksionale

- **tregtinë e hershme me vendet fqinjë të zhvilluar nga porti i Shëngjinit;**
- **objektet e lashta të kultit; - banesat karakteristike dy e tre katëshe;**
- **shkolla e hershme,**
- **personalitete të shquar brenda e jashtë vendit;**
- **veshjet karakteristike e të larmishme, këngët e vallet popullore;**
- **punimet e bukura artizanale të veçanta që vazhdojnë të punohen edhe sot.**
- **tolerancën fetare -traditën e mikpritjes dhe gatimet tradicionale.**

Rajoni i Lezhës, ka brenda tij, një areal etnokulturor me vlera unikale në historinë dhe etnosin e shqiptarëve.

Kjo pjesë e trungut të moçëm ilirik, është njëherësh djepi i një vargu personalitetesh që e kanë gdhendur emrin, jo vetëm në panteonin e kulturës shqipe, por edhe më gjerë.

Të zhvillojmë turizëm të harmonizuar bregdetar, malor, historik e etno-kulturor.

OBJEKTIVI II 6.

47Strategjia e turizmit dhe Agroturizmit në Qarkun e Lezhës

Turistët dhe kalimtarët që vizitojnë Rajonin tonë mund të prekin konkretisht krahas bregdetit pjesë të veçanta të relievit malor dhe të njihen me historinë, kulturën dhe traditat tona.

Kur flasim për qytetërim të lashtë në trevat e Lezhës kemi parasysh:

Është njëri prej qyteteve më të vjetër të Shqipërisë, i njohur në antikitet me emrin e Lisit, vendosur midis Durrhahut (Durrësit) dhe Shkodrës mbi një kodrinë me pamje nga lumi Drin. Qyteti antik Lissus, ishte një nga rezidencat e mbretit Gent.

Cezari për ca kohë e vuri nën kontroll qytetin dhe përforcoi mbrojtjen e tij.

Me emrin e Lissusit do të njihet qyteti deri në periudhën e hershme mesjetare.

Familja feudale e Dukagjinëve e pati për shumë kohë nën sundimin e vet.

Pinjollit i kësaj dëre fisnike, Lekë Dukagjini, la pas një nga vlerat më unike të trashëgimisë së kulturës dhe të fondit dokesor shqiptar:

“ Kanunin e Lekë Dukagjinit”, me kodet e të cilit u vetëqeverisën për shumë shekuj me radhë banorët e këtij Rajoni.

Lezha njihet si vendi i kuvendeve dhe i besëlidhjeve të mëdha.

Nën drejtimin e heroit tonë Kombëtarë Gjergj Kastriotit, me 2 mars 1444, u mbledh Kuvendi Kombëtar i Lezhës.

Vendvarrimi i heroit tonë Kombëtar, që ngrihet në pjesën muzeale të qytetit vizitohet nga mijëra turistë, e sidomos turistë elitare që janë të interesuar për historinë e kulturën shqipe.

Në këtë memorial që u ngrit në vitin 1981, mbi rrënojat e kishës së Shënkollit (osmanët e patën kthyer në xhami), vizitorët kanë rastin të shohin emblemat e familjeve feudale shqiptare si dhe një kopje të shpatës dhe përkrenares së Skënderbeut.

Zona muzeale e qytetit është 20 ha dhe shpallur dukshëm kulturën Ilire, Romake dhe Osmane.

Thellë këtyre viseve, ka një arkiv të nëndheshëm të pa njohur më parë, që nëpër kohëra i ka grishur arkeologët e Kontinentit të vjetër për eksplorime, të cilat vazhdojnë edhe sot, duke i sjellë njerëzimit dëshmi autentike për zhvillime mjaft të hershme. Këto dëshmi të njohura tashmë, janë të pakta përballë visarit arkeologjik që toka e mban të konservuar thellë saj, që nga thellësitë e mijëvjeçarëve.

Strategjia e turizmit dhe Agroturizmit në Qarkun e Lezhës

Jeta urbane e qytetit të Lezhës lidhet me fundin e shekullit IV p.K.

Destinacioni kryesor i turizmit është Shëngjini.

Në vitin 1440 u rindërtua nga venedikasit. Pas pushtimit osman, me 1522, u rikonstruktua nga pushtuesit. Rrënojat e ndërtesave osmane brenda kalasë, xhamia, kulla në murin juglindorë me një hark romak dhe kulla ilire, me murin jugor të saj, janë objekte

mjaft interesante për tu vizituar.

Lezha me rrethinë, ka një folk të pasur, që ruhet e transmetohet ndër breza.

Tradita e takimit kombëtar të rapsodëve dhe instrumentistëve popullorë, që ka vite që organizohet në qytetin e Lezhës, i mbledh bashkë bardët nga gjithë trojet shqiptare dhe diaspora, duke i dhënë qytetit një mozaik të mrekullueshëm me kostume e vegla popullore. Këngët majëkrahut, si dhe ato të shoqëruara me lahutë, çifteli, sharki si dhe bilbil e fyell përcjellin më së miri identitetin dhe autencitetin e folkut të këtyre viseve.

Në Lezhë dhe në ultësirën e saj nëpër kohra kanë ardhur nga krahina të ndryshme, kryesisht të Veriut, duke sjellë prurje që e kanë pasuruar në vijimësi etnografinë e arealit të Lezhës, melosin, kërcimin popullorë, mënyrën e jetesës, duke e bërë këtë oaz etno-kulturor shumë të pasur e të larmishëm.

Në gjysmën e dytë të qindvjeçarit të fundit, folku Lezhjan me gjithë gjinitë e tij, ka marrë vlerësime të larta në rrafsh kombëtar.

51Strategjia e turizmit dhe Agroturizmit në Qarkun e Lezhës

Kalaja e Lezhës

Etimologjia e këtij emër vendi, është ende e pa kthjelluar mirë. P.Gaspri dhe P. Coroneli, në hartat e tyre, limanin e quajnë San Giovanni di Medua. Kështu kemi një ndërthurje të një toponimi mitologjik pagan me emrin e një shenjtori katolik. Emri Shëngjin, vjen deri në kohët tona. Jul Qezari në “Lufta Civile” e përmend emrin e këtij gjiri si Nimfeum që në vitin 48-t para Krishtit. Në fushatën e Cezarit kundër Pompeut, erdhi edhe Flota e Mark Antonit. Emri Nymfeum, lidhet me çetën e nimfave, zanave që është edhe illi mitologjik i toponimit. Në epokën romane është njohur si një liman i mbrojtur “Tulisimuss portus”. Në mesjetë, është edhe me emra të tjerë si Meduo, Medea etj.

Sot Shëngjini është i njohur për plazhin e tij .

53Strategjia e turizmit dhe Agroturizmit në Qarkun e Lezhës

Mirdita, dheu i shtetit të parë të Arbrit me 1190, me stemën e famshme që u gjet në Gëziq të Ndërfanës, (ruhet në muzeun kombëtar), **me mbishkrimin epigrafik, me kalatë, me sarajet princërore, me kullat që u ngritën me themelet mbi bakër, përbën një areal etnokulturor ku identiteti është ruajtur në mënyrë konservative.**

Pritja e mikut, ishte dhe mbetet një çast solemn. Njeriu i këtyre anëve ndjen gëzim kur i vjen miku, por merr mbi vehte përgjegjësi për qetësinë rehatinë dhe sigurinë e tij.

Institucioni i besës është nderuar e respektuar deri në sakrifica sublime. Kjo traditë e bukur ruhet edhe sot.

Destinacion i turizmit historiko-kulturor në Mirditë janë: Ngrehinat e industrisë së bakrit si dhe 11 vendburimet e tij ,të cilat janë të konservuara e shtrihen në gjithë territorin.

E një rëndësie të veçantë, është miniera-burg e Spaçit, në komunën e Oroshit.

Kampi i të burgosurve politik të sistemit diktatorial është një dëshmi tronditëse e dhunës së pashembullt të sistemit komunist në Shqipëri. Fama e keqe këtij burgu njihet kudo ku ka shqiptarë në rruzullin tokësor. Interesante shfaqet Mirdita e nëndheshme, jo vetëm për pasuritë nëntokësore e për zgafellat që hapi dora e njeriut, por edhe për shpellat karstike që gjenden në malet e kësaj krahine si :

Shpella e Valit, Komuna Kthellë, Shpella e Mërkurthit në fshatin Mërkurth të Selitës (e pa eksploruar deri tani), Shpella e Fretërve në Lufaj të Selitës, Shpella e Akullit në Orosh, Gurra e Domgjonit në Komunën Fan, Shpella e Fatmirave në komunën Selitë, Shpella e Shutrresë në Grykë të Selitës.

Turistët e aventurës, por edhe speleologët, të cilët nuk kanë munguar t'i eksplorojnë këto shpella pas viteve 90-t, që janë një destinacion befasues turistik.

Kurbini dhe Mirdita, nuk kanë ndonjë ndryshim esencial përsa i përket mënyrës së jetesës, traditës së vetëqeverisjes dhe mikpritjes. Vetëm në veshjet e grave ka ndryshime të dukshme.

Gratë myslimane të Kurbinit kanë një veshje të veçantë e të dallueshme nga pjesa katolike e Kurbinit, e cila përdor pa ndonjë devijim kostumin mirditor të grave.

I ka rrënjët në Iliri prej nga vjen emri i tij. Në Gur të Shkopetit ndodhet Shpella e Kok Malçit, e cila u përdor si seli e shtabit ushtarak të prijësit të Skurajve në epopenë skënderbejane. Jo larg shpellës, ndodhet kalaja mesjetare e Ferr Shkopetit, Kisha e Shën ,Markut në Nërshegas, ku u çel për herë të parë shkolla shqipe më 1632.

Lugina e Shkopetit, ka në shtatin e saj liqenin e hidrocentralit të Shkopetit, i cili i jep një bukuri të rrallë luginës së Matit. Këtyre anëve vizitori ka një mozaik objektsh historiko-kulturore e natyrale në një oaz të vogël, vetëm 50 km larg kryeqytetit të vendit ,Tiranës.

Në Kurbini ndodhet Albulena, ku u fitua një nga betejat më të famshme të Skënderbeut, që është quajtur ndryshe “ Beteja e Ujit të Bardhë”.

Kalaja e Sebastes në Laç, Guri i Verores në Milot etj, janë vende me rëndësi historike.

Fshati historik i Skurajve

55Strategjia e turizmit dhe Agroturizmit në Qarkun e Lezhës

Turizmi fetar

Ndër vlerat më të spikatura të historisë dhe të kulturës shqiptare është bashkëjetesa ndërjetare. E tillë shpалoset ajo edhe në Qarkun e Lezhës, i cili ka një strukturë religjioze, ku rreth 72% e popullsisë janë të besimit katolik, 25% janë të besimit mysliman dhe 3% të besimeve të ndryshme. Nuk ekziston asnjë rast i konflikteve mes besimeve. Respekti reciprok për njëri-tjetrin është shembullor.

Në atlasin e objekteve të kultit, kemi 4 lloje prej tyre:

Kishën katolike, kishën ortodokse, xhaminë dhe teqenë.

Ky atlas, është i pasur me objekte mjaft të mëdha të krishterimit të hershëm në Shqipëri.

Historiku i kishës katolike ka mbartur dy momente të rëndësishme nëpër 15 shekuj të veprimtarisë së vet. Ajo ka përjetuar rënien gjatë shekullit të parë të pushtimit osman dhe rënien e dytë gjatë dimrit të gjatë ateist të periudhës 45 vjeçare komuniste .

Ky dimër, nuk rrafshoi vetëm kishat katolike e ortodokse, por të gjithë objektet e kultit në Shqipëri. Këto objekte u kthyen në të ashtuquajturat shtëpi kulture, por jo radhë edhe në depo për ekonomitë bujqësore. Disa prej tyre u kthyen në rrënoja.

Etnografia

